



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E AUDITIMIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR

MBI
REALIZIMIN E ANGAZHIMIT TË AUDITIMIT, NË UNIVERSITETIN “EQREM
ÇABEJ”, GJIROKASTËR

I. Përbledhje ekzekutive

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër (shkurt UGJ), është institucion publik i arsimit të lartë, i krijuar me Vendimin e KM-së, Nr.414, datë 12.11.1991, mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik 3-vjeçar, krijuar me vendim të KM-së nr.4, datë 08.01.1971.

Universiteti “Eqrem Çabej”, është organizuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me aktet nënligjore për arsimin e lartë dhe me Statutin dhe Rregulloret e Brendshme të tij. Statuti i Universitetit është miratuar nga Senati Akademik me vendimin nr.20, datë 30.08.2021, si dhe nga Bordi i Adminsitritimit me vendimin nr.34, datë 12.08.2021. Rregullorja e brendshme e Universitetit “Eqrem Çabej, sipas periudhave është miratuar me vendimet nr.7, datë 19.05.2011, nr.9, datë 12.07.2013, nr.34, datë 20.12.2016 dhe nr.26 datë 8.09.2020 të Senatit Akademik, ku përcaktohen dhe trajtohen misioni, qëllimi, organizimi strukturor i UGJ, detyrat dhe funksionet e organeve dhe autoriteteve drejtuese, punësimi i personelit akademik dhe administrativ, programet e studimit dhe organizmi i tyre, si dhe kriteret e rregullat e disiplinës së punës etj.

UGJ synon të arrijë standard cilësore në fushën akademike dhe të përgatitë profesionistë të zotë, sipas programeve përkatëse të studimit, të rritë cilësinë e kërkimit në fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, si dhe të jetë qendër e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm e rajonit jugor.

Objekti i veprimtarisë, organizimi dhe funksionimi i Universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, është i përcaktuar në Statut dhe rregulloret e miratuara dhe ka për mision:

- *Të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si edhe të formojë specialistë të lartë dhe shkencëtar të rinj;*
- *Të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës;*
- *Të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare;*
- *Të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e studentëve për një shoqëri të tillë.*

Objektivi kryesor për çështjet e auditimit ka qenë, vlerësimi i plotë i veprimeve të marra nga menaxhimi i UGJ, në drejtim të elementeve të kontrollit, si edhe mbi të gjitha aktivitetet strategjike, funksionale apo operative, me qëllim shprehjen e opinionit mbi funksionimin e kontolleve, mbi mbajtjen në nivele të pranuara të risqeve të identifikuara dhe kryerjen e veprimtarive, në funksion të arritjes së objektivave të planifikuara me ekonomi, efektivitet dhe eficencë, si dhe në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara.

Drejtoria e Auditimit, auditoi subjektin UGJ, duke i kushtuar vëmendje objektivave kryesore të sistem/fushave, që lidhen me:

- zbatimin e rekomandiave të lëna nga auditimet e mëparshme;
- sistemin e drejtimit dhe strukturës organizative;
- funksionimin e Bordit të Administrimit;
- sistemin e pagave dhe përputhshmëria me legjislacionin;
- sistemin e buxhetit dhe burimet e financimit;
- sistemin e prokurimeve të fondeve publike;
- sistemin e kontabilitetit finansiar;
- sistemin për menaxhimin e aktiveve;
- sistemin mbi përdorimin e fondeve për bursat;

Misioni dhe qëllimi i auditimit: është vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazë rishku, si dhe dhënia e një sigurie objektive të arsyeshme niveli të lartë të menaxhimit, me qëllim për të shtuar vlerën e përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike, duke ndihmuar për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të menaxhimit.

Periudha e audituar: Nga data 01.05.2018 deri më datën 31.05.2022.

Auditimi u krye: Nga data 27.06.2022 deri me datë 16.07.2022.

Auditimi u realizua, sipas drejtimeve të përcaktuara në programin e angazhimit të auditimit nr.4116/1 prot., datë 24.06.2022.

Rezultatet e auditimit, përbledhje e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve:

- Nga 5 rekomandime të lëna nga auditimet e mëparshme ishin realizuar 3, ishte realizuar pjesërisht 1, dhe nuk ishte realizuar rekomandimi :“*Të merrën masa urgjente për të vënë në eficencë ish godinën e ushtarakeve, e cila është në administrim të Universitetit*”.
- Struktura organike e UGJ, për vitin 2022, është miratuar me numrin e përgjithshëm të personelit 181 gjithsej dhe në fakt funksionon me 175, nuk është plotësuar për 6 vende pune, jo në përputhje me strukturën organike të miratuar.
- Lidhur me vlerësimin e performancës në punë të punonjësve u konstatua se për periudhën objekt auditimi, nuk ishin kryer vlerësimet vjetore të punës, referuar përcaktimeve në pikën 19, të rregullores së brendshme nr.10921/9 Prot., datë 08.09.2020 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndihmës Akademike-Administrative”, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.26, datë 08.09.2020.
- Lidhur me plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacion u konstatuan parregullsi të karakterit të përputhshmërisë ligjore, pasi nuk ka fletë inventari, nuk ka fletë prezantuese të dosjes teknike, si dhe dokumentacioni i dosjeve është fotokopje dhe jo kopje e noterizuar jo në përputhje me përcaktimet në kreun II, pika 1, lidhjet nr.1 dhe nr.2, të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përbajtjen, procedurën e administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendorr të personelit”.
- BA, ka ushtruar funksionet e tij sipas përcaktimeve në aktet ligjore në fuqi, por u konstatua se akoma nuk është miratuar rregullorja financiare e universitetit, referuar përcaktimeve të nenit 49 pika ‘e’, të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015, ku citohet: “*Jep mendim për*

projektrregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij”, si dhe përcaktimave në nenin 21, pika 4, të statutit, ku citohet: “*Miraton rregulloren për administrimin, financat dhe kontabilitetin*”. Gjithashtu u konstatua se diskutimet e anëtarave të BA, gjatë mbledhjeve që zhvillon nuk dokumentohen (mbahen me shkrim me portokoll) apo të regjistrohen me audio, por është mjaftuar me përpilimin e proces-verbalit në përfundim të mbledhjes. Kjo mangësi duhet të rregullohet me një ndryshimin në rregulloren e brendshme të Bordit të Administrimit.

- Sistemi e pagave ka funksionuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi, por u konstatua se përllogaritja dhe mbajtja e tatimit mbi të ardhurat në rastin e pagesave të honorarëve për projektet e realizuara, pagesat e orëve shtesë mbi pagë të punonjësëve të personelit akademik, si dhe pagesat e pedagogëve të ftuar, nuk është bërë sipas kërkesave Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.3 “Të ardhurat e tatueshme”, nënpika 2.3.1 germa ‘b’, ku citohet: “*Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komite, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikëqyrëse etj., paguhet në qendrën efektive të punës së individit, këto të ardhura do të tatohen duke u bashkuar me pagën e muajit përkatës*”.
- Lidhur me deklarimet në sistemin tatimor u konstatuan parregullsi të karakterit të përputhshmërisë ligjore, pasi gjatë viteve 2019-2020, ishin bërë deklarime me vonesë për punonjësit apo deklaratat tatimore, veprime jo në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 64, të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe me pikën 3, të nenit 11, të Ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të cilën UGJ është penalizuar me gjobë në shumën 184 265 lekë nga organet tatimore.
- Për hartimin e buxheteve dhe menaxhimin e programeve, të viteve 2018, 2019 2020 dhe 2021, nuk ishin ngritur grupet e punës, nuk ishte bërë dokumentimi e argumentimi i tyre për sa i përket mënyrës së llogaritjes së fondeve për çdo program dhe çdo njësi, veprime jo në përputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.
- Në fushën e prokurimit të fondeve publike, u konstatua parregullsi e karakterit të përputhshmërisë ligjore, pasi nuk ishte dokumentuar përllogaritja vlerës së kontratave, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet, si dhe e fondit limit për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve, për çdo rast të prokurimit të tyre me vlerë të vogël.
- Nga auditimi i sistemit të kontabilitetit financiar u konstatuan mangësi si vijon:
 - Në bilancet e viteve 2020 dhe 2021, gjendjet e llogarive të “Aktiveve afat gjata materiale” dhe llogarive të “Inventarit Qarkullues”, janë pasqyruar me vlerën e tyre kontabel, pa u krahasuar me gjendjen fizike të inventarizimit, duke bërë që të dhënat për treguesit sasiore dhe ato të vlerës, të këtyre llogarive të mos janë të plota, të sakta e të besueshme, në mos përputhje me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
 - Drejtoria e Financës e UGJ, në pasqyrat finaciare të vitit ushtrimor 2021, ka pakësuar llogarinë ‘218’ “*Inventar ekonomik*” në vlerën - 3 535 647 lekë, në mënyrë mekanike përfundimtare, pasqyruar me vlerën e tyre kontabel, pa u krahasuar me gjendjen fizike të inventarizimit, duke bërë që të dhënat për treguesit sasiore dhe ato të vlerës, të këtyre llogarive të mos janë të plota, të sakta e të besueshme, në mos përputhje me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
 - Urdhër shpenzimeve të pagesave për ‘*Shpenzime specifike (Projekte)*’ dhe ‘*Honorare*’, nuk u bashkëlidheshin të gjitha dokumentet vertetues/justifikues si: Marrëveshjet e lidhura, Kontratat, Urdhëri i titullarit, dokumenti final i punës, situacioni i shpenzimeve etj.

- Lidhur me menaxhimin e aktiveve u konstatuan parregullsi të karakterit të përputhshmërisë ligjore si vijon:
 - Njësia publike, nuk kishte hartuar gjurmët specifike të auditimit të nevojshme për menaxhimin e aktiveve që disponon, si dhe gjurmët standarde të auditimit, në mos përputhje me përcaktimet në paragrafët 121-122, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
 - Nuk është hartuar regjistri kontabël për të gjitha aktivet që zotëron apo ka në administrim Universiteti, i cili duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet që gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital.
 - Nuk është hartuar relaciuni për vlerësimin e aktiveve, referuar kërkesave të përcaktuara në paragrin 106, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
 - Nuk ishin bërë rakordimet mujore, për konsumin e karburantit nga automjetet, që përdoren nga UGJ, ku të pasqyrohej gjendja e karburantit në fillim të muajt, sasia e furnizuar, konsumi mëjor referuar normativës së konsumit, si dhe gjendja në fund të muajit.
 - Sistemi mbi përdorimin e fondeve për bursat rezultoi në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Mangësi të konstatuara:

1. Struktura organike e UGJ, për vitin 2022, është miratuar me numrin e përgjithshëm të personelit 181 gjithsej dhe në fakt funksionon me 175, nuk është plotësuar për 6 vende pune, jo në përputhje me strukturën organike të miratuar.

Rekomandim: Strukturat përkatëse të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, të bashkëpunojnë për realizimin e procedurave dhe plotësimin e strukturës organike, në përputhje me atë të miratuar, me qëllim përbushjen e objektivave.

2. Për periudhën objekt auditimi, nuk ishin kryer vlerësimet vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, referuar përcaktimeve në pikën 19, të rregullores së brendshme nr.10921/9 prot., datë 08.09.2020 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndihmës Akademike-Administrative”, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.26, datë 08.09.2020.

Rekomandim: Të bëhen rregullisht vlerësimet vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, referuar përcaktimeve në pikën 19, të rregullores së brendshme nr.10921/9 Prot., datë 08.09.2020.

3. Në dosjet e personelit u konstatuan mangësi, pasi nuk ka fletë inventari, nuk ka fletë prezantuese të dosjes teknike, si dhe dokumentacioni i dosjeve është fotokopje dhe jo kopje e noterizuar jo në përputhje me përcaktimet në kreun II, pika 1, lidhjet nr.1 dhe nr.2, të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përbajtjen, procedurën e administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrat qendorr të personelit”.

Rekomandim: Njësia e burimeve njerëzore në UGJ, të bëjë plotësimin, sistemimin dhe administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar, referuar përcaktimeve në VKM-në nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrat qendorr të personelit”.

4. Nuk ishte miratuar rregullorja për administrimin, financat dhe kontabilitetin, kërkesë e përcaktuar në nenin 49 pika ‘e’, të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 dhe nenin 21, pika 4, të statutit.

Rekomandim: Të merren menjëherë masa për hartimin dhe miratimin e rregullorës për administrimin, financat dhe kontabilitetin, referuar përcaktimeve në aktet ligjore në fuqi.

5. Gjatë viteve 2019-2020, ishin bërë deklarime me vonesë në sistemin tatimor për punonjësit apo deklaratave tatimore, veprime jo në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 64, të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, si dhe me pikën 3, të nenit 11, të Ligjit nr.9136, datë 11.9.2003.
- Rekomandim:* UGJ, për deklarimet e punonjësve në sistemin tatimor të marrë masa për respektimin e afateve ligjore dhe vendosjen e kontolleve të nevojshme, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi.
6. Aplikimi i tatimit mbi pagesat e honorarëve për projektet e realizuara, pagesat e orëve shtesë mbi pagë të punonjësve të personelit akademik, si dhe pagesat e pedagogëve të stuar, nuk është bërë sipas përcaktimeve në aktet përkatëse ligjore në fuqi.
- Rekomandim:* UGJ të analizojë rastin, të nxjerri përgjegjësinë, të bëjë përllogaritjet për tatimin mbi të ardhurat, për periudhën e audituar, për çdo rast e punonjës, si dhe për diferençat e konstatuara të pa mbajtura të nxirren urdhër ç'dëmtimet, të kontabilizohen veprimet dhe të bëhen ndalesat përkatëse dhe të xhirohen në buxhetin e shtetit.
7. Mos ngritja e grupeve të punës për hartimin e PBA-ve dhe menaxhimin e programeve, mos dokumentimi e argumentimi i tyre për sa i përket mënyrës së llogaritjes së fondevë për çdo program dhe çdo njësi, veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.
- Rekomandim:* Strukturat përgjegjëse për hartimin e projektbuxhetit, në vijim urdhërit të titullarit të institucionit “Për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programit”, me qëllim menaxhimin efektiv të programeve buxhetore, të marrin masat për hartimin e dokumentit të projektbuxhetit për periudhat e ardhshme në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor, me qëllim përcjelljen për në MAS të një informacioni sa më të plotë dhe të saktë, duke përfshirë deklaratën e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit.
8. Nuk ishte dokumentuar përllogaritja vlerës së kontratave, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet, si dhe e fondit limit për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve, për çdo rast të prokurimit të tyre me vlerë të vogël.
- Rekomandim:* Në çdo rast që prokurohen fonde nga njësia publike, përpëra nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, të argumentohet dhe të dokumentohet përllogaritja e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet, si dhe në çdo rast të prokurimit me vlerë të vogël, komisioni i prokurimit pasi ti ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës të përllogaritë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë (*nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme*), referuar përcaktimeve ligjore në fuqi.
9. Në bilancet e viteve 2020 dhe 2021, gjendjet e llogarive të “Aktiveve afat gjata materiale” dhe llogarive të “Inventarit Qarkullues”, janë pasqyruar me vlerën e tyre kontabel, pa u krahasuar me gjendjen fizike të inventarizimit, duke bërë që të dhënë përtreguesit sasiore dhe ato të vlerës, të këtyre llogarive të mos jenë të plota, të saktë e të besueshme, në mos përputhje me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
- Rekomandim:* Hartimi, përgatitja, paraqitja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore nga UGJ, të bëhet bazuar në rregullat dhe parimet e kontabilitetit të sektorit publik, të miratuara nga Ministria e Financave, duke siguruar kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, me qëllim që të jepin një pamje të strukturuar të pozicionit finanziar dhe transaksioneve, si dhe informacion të besueshëm për vendimmarrje për vetë njësinë.

10. Drejtoria e Financës e UGJ, në pasqyrat financiare të vitit ushtrimi 2021, ka pakësuar llogarinë ‘218’ “*Inventar ekonomik*” në vlerën - 3 535 647 lekë, në mënyrë mekanike përfekt të rakordimit të shumave, veprime këto jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, dhe Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë të gjitha masat përrregullimin e shumës 3 535 647 lekë, e paraqitur si pakësim në llogarinë ‘218’ “*Inventar ekonomik*”, në mënyrë mekanike përfekt të rakordimit të shumave, si dhe të bëjë sistemi të duhura në kontabilitet, duke reflektuar korrigjimet në pasqyrat financiare të vitit 2021.

11. Urdhër shpenzimeve të pagesave për ‘*Shpenzime specifike (Projekte)*’ dhe ‘*Honorare*’, nuk u bashkëlidheshin të gjitha dokumentet vertetues/justifikues si: Marrëveshjet e lidhura, Kontratat, Urdhëri i titullarit, dokumenti final i punës, situacioni i shpenzimeve etj.

Rekomandim: Struktura përgjegjëse përmajtjen e kontabilitetit në UGJ në të gjitha rastet e pagesave ti bashkëlidhë Urdhër Shpenzimeve dokumentacionin vertetues/justifikues, i cili duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen që ka përfekt, të përbajë të dhëna përfshakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative, referuar përcaktimëve në aktet ligjore në fuqi.

12. Njësia publike, nuk kishte hartuar gjurmët specifike të auditimit të nevojshme përfekt menaxhimin e aktiveve që disponon, si dhe gjurmët standarde të auditimit, në mos përputhje me përcaktimet në paragrafet 121-122, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Rekomandim: Njësia publike, të hartoja gjurmët specifike të auditit të nevojshme përfekt menaxhimin e aktiveve që disponon, si dhe gjurmët standarde të auditit, referuar përcaktimëve në paragrafet 121-122, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

13. Nuk është hartuar regjistri kontabël përfekt të gjitha aktivet që zotëron apo ka në administrim Universiteti, i cili duhet të përfshijë si aktivet afatgjata ashtu edhe aktivet afatshkurtra materiale dhe monetare si dhe të specifikojë aktivet që gjenden në pronësi të njësisë dhe ato që gjenden nën administrimin e njësisë në formën e pjesëmarrjeve në kapital.

Rekomandim: Të hartoja regjistri kontabël përfekt të gjitha aktivet që zotëron apo ka në administrim UGJ, si dhe të përditësohen në vazhdimësi të dhënat, me qëllim mirëmenaxhimin e aktiveve, referuar përcaktimëve të Kreut III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, paragrafet 26-72, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

14. Nuk është hartuar relaciioni përfekt menaxhimin e aktiveve, referuar kërkesave të përcaktuara në paragrafin 106, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Rekomandim: Në përfundim të procesit të vlerësimit të aktiveve, të hartoja relaciioni, i cili të përbajë procedurën e ndjekur përfekt menaxhimin e aktiveve përfekt nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektit ekonomik të masave përfekt riaftësimin e tyre dhe propozimin përkates, referuar përcaktimëve të paragrafit 106, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, dt.27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

15. Nuk ishin bërë rakordimet mujore, për konsumin e karburantit nga automjetet që përdoren nga UGJ, ku të pasqyrohej gjendja e karburantit në fillim të muajt, sasia e furnizuar, konsumi më i madhi referuar normativës së konsumit, si dhe gjendja në fund të muajit.
- Rekomandim:* Për çdo muaj të bëhen rakordimet mbi konsumin e karburantit, për automjetet e UGJ, ku të pasqyrohet gjendja e karburantit në fillim, sasia e furnizuar, konsumi më i madhi, si dhe gjendja në fund të muajit me qellim mirë administrimin e karburantit.
16. Bordi i Administrimit në funksion të kryerjes së përgjegjësive dhe realizimit të objektivave, të marrë masa për të përmirësuar rregulloren e brendshme të tij, lidhur me dokumentimin me shkrim (mbajtjen me protokoll) të diskutimeve të anëtarëve, mbi bazën e të cilit të hartohet e proces-verbali i mbledhjeve.

Opinioni i përgjithshëm mbi veprimtarinë e UGJ, është se sistemet e kontrollit sipas sistem/fushave të audituara për periudhën objekt auditimi, kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi, përvèç gjetjeve të trajtuar në raport.

II. Hyrje

Misioni i auditimit, në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastër zhvillua në zbatim të planit vjetor të auditimit, të miratuar nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.5754/I prot., datë 18.10.2021, si dhe programit të auditimit nr.4116/I, datë 24.06.2022.

Me datë 27.06.2022, në UGJ, u zhvillua takimi i hapur për prezantimin e grupit të auditimit dhe të objektivave të misionit të auditimit me drejtuesit e entitetit të përfaqësuar nga Rektori, z.Bektash Memi, Administratori z.Semi Golemi, Drejtori ekonomik znj.Marianthi Xha.

Auditimi u krye për periudhën nga data 01.05.2018 deri më 31.05.2022, sipas drejtimeve në programin përfundimtar, pas dakortësimit me përfaqësuesit e UGJ, në takimin e hapur. Gjatë auditimit u shqyrtua me zgjedhje dhe në tërësi sipas rastit, çështjeve dhe nivelit të riskut, dokumentacioni i kërkuar i vënë në dispozicion nga UGJ.

Baza ligjore:

- Ligji nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Manuali i auditimit të brendshëm, i ndryshuar;
- Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencorë në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin finanziar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- VKM, Nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimet Publike”, i ndryshuar;
- VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;
- VKM nr.918, datë 29.12.2014, “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 25/2018, date 10.05.2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Standardet kombëtare të kontabilitetit;
- Vendimet e Këshillit të Ministrave “Për pagat”;
- Vendimet e Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë”;

- Udhëzime të Ministrit të Arsimit “Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”;
- Udhëzime të Ministrit të Arsimit “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimorë të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”;
- Akte ligjore e nënligjorë “Paketa Studenti”;
- Statuti dhe rregullorja e universitetit;
- Si dhe çdo akt tjeter ligjor që lidhet me veprimtarinë e universitetit.

Arsyet për auditim janë vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e vlerësimit të riskut, si dhe dhënia e një sigurie objektive të arsyeshme nivelit të lartë të menaxhimit nëse sistemet e kontrollit për periudhën objekt auditimi kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi, në njësinë e audituar.

Misioni i Auditimit u realizua në zbatim të programit të angazhimit të auditimit nr.4116/I prot, datë 24.06.2022, nga grupi i auditit i Drejtorisë së Auditit në MAS i përbërë nga: Skënder Jaku, Novruz Ahmeti, Ilirjana Çina dhe Isa Neza.

III. Metodat e auditimit të përdorura gjatë kryerjes së auditimit, të sistemeve të kontrollit të brendshëm, të cilat kanë si qëllim marrjen e informacionit të detajuar dhe të mjaftueshëm nga personat e autorizuar, janë:

- a. “*intervistimi*”, duke përdorur teknikat e pyetësorëve përkontrollet e brendshme të cilat janë përgatitur paraprakisht, si edhe analizimi i dokumentacionit.
- b. “*Testimi hap pas hapi*”, që përfaqëson ndjekjen brenda sistemit të transaksioneve specifike nga fillimi deri në fund, përfshin edhe procedurave të caktuara.
- c. *Testimi i detajuar*, që përfshin ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, e cila na jep evidenca më të besueshme se sa intervistimi dhe e përdorim pasi kemi planifikuar që të marrin të dhëna nga të gjithë transaksionet (ose nga një shembull për transaksion) në një grupim.

Teknikat e auditimit të përdorura janë:

- i. *Sondazhet*, që duhet të përfshijnë jo më pak se 25 % të transaksioneve përfshin përkatëse me qëllim që zgjedhja të jetë përfaqësuese dhe përfshin bindjet e arsyeshme përvërtetësinë e operacioneve të audituara.
- ii. *Përzgjedha me gjykim*, që kërkon një vlerësim profesional, është më eficiente dhe ekonomike e përdoret ku madhësia e përzgjedhjeve është e vogël ose aty ku nuk pritet që rastësia të na japë përzgjedhje që mund të përfaqësojnë masën, tërësinë e proceseve a transaksioneve.

Në përfundim të angazhimit tëauditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, testeve, pyetësorëve dhe shqyrtimit të shpjegimeve të personave të subjektit të audituar, u përgatitet projekt-raporti i auditimit, i cili me shkresën nr.4116/2, datë 27.07.2022, i është dërguar UGJ, në të cilin janë sugjeruar rekomandimet, përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, në të ardhmen. UGJ, me shkresën nr.697/3 prot., datë 12.08.2021 “Objeksione mbi projekt reportin”, është shprehur dakord me gjetjet dhe rekomandimet e lëna, si dhe ka cilësuar masat që do të merren për zbatimin e tyre.

Grupi i auditimit mbështetur në Manualin e Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar, Kapitulli IV, pika 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”, dërgon reportin përfundimtar të auditimit dhe pret nga subjekti i audituar plan veprimin e plotësuar nga ana e tij.

III. Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet për çdo sistem, sipas drejtimeve të auditimit të miratuara në program.

1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, programet e hartuara nga subjekti për zbatimin dhe realizimi i tyre.

Nga auditimi i mëparshëm janë lënë 5 rekomandime, të cilat janë realizuar si më poshtë:

Rekomandimi nr.1: “Të merren masa urgjente për të vënë në eficencë ish godinën e ushtarakecve, e cila është në administrim të Universitetit”. *Ky rekomandim nuk është realizuar, pasi për mungesë fondesh kjo godinë akoma nuk është vëne në shërbim të këtij institucioni.*

Rekomandimi nr.2: “Për pagesën e orëve mbi normën e ngarkesës, në zbatim me kërkesat e udhëzimit nr.20, Bordi Administrativ, për tejkalimin e normës së ngarkesës mbi 30 % të marrë vendim pas miratimit nga Ministri i Arsimit”. *Ky rekomandim është realizuar.*

Rekomandimi nr.3: “Menjëherë të rishikohen kontratat për dy ambiente me qira, në ambientet e shtëpisë ushtarakeve cila është në përgjegjësi administrative të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pasi janë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 16.06.2011, sipas së cilës Ministrisë së Arsimit si përgjegjëse e administrit të pronës „...i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1 (Përdorim për zgjerimin e mjediseve mësimore e studimore...“), ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve”. *Ky rekomandim është realizuar.*

Rekomandimi nr.4: “Në përfundim të inventarizimit të përpilohet një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve dhe t’i dorëzohet për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues, si dhe të përgatitet relaciioni për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, ku të sqarohen arsyet, efektin ekonomik të masave përriafësimin e tyre dhe propozimin përkatës”.

Ky rekomandim është realizuar pjesërisht, sepse:

a) Raport i inventarizimit fizik të aktiveve është hartuar me mangësi dhe nuk i përgjigjet kërkesave të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik”, i ndryshuar

b) Në dosjen e inventarizimit të aktiveve, mungon relaciioni për vlerësimin e aktiveve që do të nxirren nga përdorimi.

Rekomandimi nr.5: “Të merren në kohë masat organizative, përrrealizimin e fondeve për investime”. *Ky rekomandim është realizuar.*

2. Auditim i sistemit të drejtimit dhe strukturës organizative, struktura organizative dhe organigrama e universitetit, përputhshmëria me legjislacionin dhe objektivat, përputhja e kritereve profesionale të punonjësve, me kërkesat e vendit të punës, përshkrimi i punës për çdo pozicion pune, vlerësimi i performancës së punonjësve, zbatimi i kritereve të përcaktuara për punësimet e reja dhe plotësimi i dosjeve të punonjësve me dokumentacion.

Për realizimin e angazhimit të auditimit, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore u grumbullua informacion në lidhje me procedurat e rekrutimit të punonjësve si dhe u krye verifikimi i dosjeve të personelit të këtij institucioni.

Stafi i deklaruar nga institucioni është i përbërë nga stafi akademik, ndihmës akademik, administrative dhe ndihmës administrative.

Për periudhën objekt auditimi, UGJ “Eqerem Cabej” ka funksionuar në bazë të ligjit të saj organik. Në nenin 5 të Statutit “Misioni”, ka përcaktuar deklaratën e misionit të UGJ, ku thuhet se Universiteti “Eqerem Çabej” ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet

me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve si dhe të formojë specialist të lartë gjatë gjithë jetës. Gjithashtu, UGJ ka si mision të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës.

Grupi i auditimit evidenton se struktura e UGJ është në përputhje me nenin 22, të Ligjit 80/2015, ku përcaktohet se “*Institucionet e arsimit të lartë përbëhen nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas percaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.*”

Në lidhje me harmonizimin e shtrirjes dhe larminë e madhësisë së aktiviteteve me strukturën organizative të njësisë, konstatohet se kjo e fundit është në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MAS me nr.27, datë 29.12.2017 “Për strukturën e brendshme administrative e akademike në IAI.” Në mënyrë të detajuar struktura organizative e universitetit “Equerem Çabej”, Gjirokastër është si më poshtë:

- Fakulteti i edukimit dhe shkencave shoqërore, i cili ka në përbërje 6 deparamente dhe 2 grupe mësimore të kërkimit shkencor sipas percaktimeve të nenit 14 të statutit.
- Fakulteti i shkenacve të natyrës i cili ka në përbërje 3 deparamente dhe 2 grupe mesimore të kërkimit shkencor sipas percaktimeve të nenit 14 të statutit.
- Fakulteti ekonomik, i cili ka në përbërje 3 deparamente.

Në stafin akademik përfshihet stafi i brendshëm (me kontratë me kohëzgjatje të pacaktuar dhe me kontratë me kohëzgjatje të caktuar).

Struktura e Universitetit “Equerem Çabej për kohën e auditimit paraqitet, si në vijim:

a. Gjatë vitit akademik 2018-2019, Universiteti “Equerem Çabej” ka operuar me strukturën e miratuar nga Senati Akademik me vendimin nr.03, datë 07.02.2019, ku referuar gërmës ‘ç’ të nenit 38, të Ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” i është propozuar Bordit të Administrimit për miratim. Ky i fundit referuar nenit 49 të ligjit, me vendimin nr.14, datë 12.02.2019, ka miratuar strukturën e dërguar nga Senati Akademik, me numrin e personelit në të gjitha nivelet.

Sipas deklarimeve të institucionit numri total i punonjësve të miratuar për vitin 2018-2019 është 194.

Më poshtë jepen të dhëna të përgjithshme për numrin e personelit sipas kategorisë:

Nr.	Emërtimi i kategorisë	Numri i punonjësve
1	Personel akademik me kohë të plotë	112
2	Pesonel ndihmës akademik me karakter mësimor/administrative në fakultete	17
3	Pesonel ndihmës akademik me karakter mësimor/administrative në rektorat	44
4	Personel i parashikuar për kategorinë 1, 2 dhe 3	194
	Personel në fakt	173
5	Personel akademik me kohë të pjesshme	70

Siq vihet re nga të dhënat në tabelë numri i punonjësve fakt me kohët të plotë është 173 nga 194 sipas deklarimit të drejtorisë së shërbimeve ndihmës akademike-administrative, ose 21, më pak se parashikimi.

b. Gjatë vitit 2019-2020, Universiteti “Equerem Çabej” ka operuar me strukturën e miratuar nga Senati Akademik me vendimin nr.12, datë 5.02.2020, ku referuar gërmës ‘ç’ të nenit 38, të

ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” i është propozuar për miratim Bordit të Administrimit. Ky i fundit referuar nenit 49 të ligjit, me vendimin nr.12, datë 07.02.2020, ka miratuar strukturën e dërguar nga Senati Akademik, me numrin e personelit në të gjitha nivelet, si dhe një ndryshim në strukturë, ku është bërë shtimi i dy vendeve të reja në pozicionin “Roje”.

Numri i personelit fakt dhe të parashikuar sipas kësaj strukture është, si vijon:

Nr.	Emërtimi i kategorisë	Numri i punojësve
1	Personel akademik me kohë të plotë	107
2	Pesonel ndihmës akademik me akarakter mësimor/administrative në fakultete	17
3	Pesonel ndihmës akademik me akarakter mësimor/administrative në rektorat	48
4	Personel i parashikuar për kategorinë 1, 2 dhe 3	188
	Personel në fakt	172
5	Personel akademik me kohë të pjesshme	65

Sic vihet re nga të dhënat në tabelë numri i punojësve fakt me kohët të plotë është 172 sipas deklarimit të drejtorisë së shërbimeve ndihmës akademike-administrative, nga 188 sipas parashikimit në strukturën e institucionit, ose ose 16, më pak se parashikimi.

c.Për vitin 2020-2021, sipas deklarimeve të institucionit nuk ka strukturë të re, por është punuar me strukturën e vitit paraardhës.

Nr.	Emërtimi i kategorisë	Numri i punojësve
1	Personel akademik me kohë të plotë	106
2	Pesonel ndihmës akademik me akarakter mësimor/administrative në fakultete	17
3	Pesonel ndihmës akademik me akarakter mësimor/administrative në rektorat	51
4	Personel i parashikuar për kategorinë 1, 2 dhe 3	190
	Personel në fakt	174
5	Personel akademik me kohë të pjesshme	80

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se numri i punojësve fakt me kohë të plotë është 174 nga 190 sipas deklarimit të drejtorisë së shërbimeve ndihmës akademike-administrative, ose ose 16, më pak se parashikimi. Ndërkaq, ka një rritje të numrit të personelit akademik me kohë të pjesshme.

d.Për vitin 2022, me vendimin nr.02, datë 10.02.2022 të Rektoratit “Për strukturën e përgjithshme të UGJ-së dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet”, është miratuar struktura e institucionit për t’ia përcjellë Senatit Akademik, i cili me vendimin nr.07, datë 16.02.2022 “Për strukturën e përgjithshme të UGJ-së dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet”, pika 2, i është përcjellë Bordit të Administrimit për miratin e numrit të personelit të UGJ-së në të gjitha nivelet.

Struktura e re është miratuar me vendimin nr.12, datë 01.03.2022, të Bordit të Administrimit, e cila numrin e përgjithshëm të personelit e ka 181 gjithsej.

Në vitin 2022 struktura organizative e institucionit është si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i kategorisë	Numri i punonjësve
1	Personel akademik me kohë të plotë	106
2	Pesonel ndihmës akademik me karakter mësimor/administrative në fakultete	17
3	Pesonel ndihmës akademik me karakter mësimor/administrative në rektorat	52
4	Personel i parashikuar për kategorinë 1, 2 dhe 3	181
	Personel në fakt	175
5	Personel akademik me kohë të pjesshme	80

Krahasuar me vitin 2020, ka një rënie të numrit të punonjësve në strukturën e institucionit, me 9 punonjës në total, e përligjur kjo me faktin e rënies së numrit të studentëve.

Nëse do të krahasonim katër strukturat për vitet objekt auditimi të trajtuarë më lartë, rezulton se përvitjet 2018 -2021, paraqitet një ulje e numrit të personelit efektiv në raport me parashikimin, i cili shkon nga 5 deri në 21 punonjës.

Pavarësisht faktit që, janë zhvilluar disa konkurse për rekrutimin dhe plotësimin e pozicioneve të punësimit (2019-2021), rezulton se: Ende numri i personelit akademik dhe atij ndihmës nuk është plotësuar sipas strukturës së miratuar, në një trend pothuajse të njëjtë në gjithë periudhën nën auditim.

Titulli i gjetjes: Struktura organike e UGJ, përvit 2022, është miratuar me numrin e përgjithshëm të personelit 181 gjithsej dhe në fakt funksionon me 175, nuk është plotësuar përvit 6 vende pune, jo në përputhje me strukturën organike të miratuar.

Nr. i Gjetjes 1	
Subjekti i audituar	Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër (UGJ).
Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetja	UGJ; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përbledhja e bazës ligjore	Vendimi i Rektoratit nr.02, datë 10.02.2022 "Për strukturën e përgjithshme të UGJ-së dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet"; Vendimi i Senatit Akademik nr.07, datë 16.02.2022 "Për strukturën e përgjithshme të UGJ dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet", pika 2; Vendimi nr.12, datë 01.03.2022, i Bordit të Administrimit, që ka miratuar strukturën me numrin e përgjithshëm të personelit 181 gjithsej.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Struktura organike e UGJ, përvit 2022, është miratuar me numrin e përgjithshëm të personelit 181 gjithsej dhe në fakt funksionon me 175, nuk është plotësuar përvit 6 vende pune. Kriteri: Kjo situatë nuk është sipas kërkuesave të Vendimit të Rektoratit nr.02, datë 10.02.2022 "Për strukturën e përgjithshme të UGJ-së dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet"; Vendimit të Senatit Akademik nr.07, datë 16.02.2022 "Për strukturën e përgjithshme të UGJ dhe numrin e personelit në të gjitha nivelet", pika 2;

	Vendimit nr.12, datë 01.03.2022, të Bordit të Administrimit, që ka miratuar strukturën me numrin e përgjithshëm të personelit 181 gjithsej. Efekti: Pa ndikim financiar, por me ndikim në përbushjen e objektivave të njësisë. Shkaku: Mos kryerja e procedurave për plotësimin e strukturës.
Vlerësimi i nivilet të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Bazuar në opinionin e mësipërm, nivelin e riskut për këtë rast e vlerësojmë: Të mesëm.
Konkluzioni	UGJ nuk kryer procedurat për plotësimin e strukturës organike të miratuar për vitin 2022, me personel akademik dhe atij ndihmës, për 6 pozicione pune.
Rekomandimi	Strukturat përkatëse të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër, të bashkëpunojnë për realizimin e procedurave dhe plotësimin e strukturës organike, në përputhje me atë të miratuar, me qëllim përbushjen e objektivave.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, auditi shprehet se për periudhën objekt auditimi sistemet e kontrollit në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.

Përputhja e kritereve profesionale të punonjësve, me kërkeat e vendit të punës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të institucionit në lidhje me përputhjen e kritereve profesionale me kërkesat e vendit të punës, rezulton se:

- Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e tyre sipas kuadrit ligjor dhe dispozitat e kodit të punës. Struktura dhe procedurat e brendshme garantojnë se funksionet dhc punonjësit mbikëqyren në kryerjen e detyrave të tyre nga eprorët, apo nivelet e duhura menaxheriale.
- Ka përputhje të kritereve profesionale me kërkesat e vendit të punës për punonjësit aktual.
- Njësitet bazë plotësojnë kriterin e përcaktuar në pikën 4, të nenit 25 të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Përshkrimi i punës për çdo pozicion dhe vlerësimi i përformancës së punonjësve.

Në zbatim të pikës 5, të nenit 27, të rregullores së institucionit përcaktohet se pas kryerjes së procedurave për përgjedhjen e personelit akademik të ftuar ljdhet kontrata e punës nga rektori.

Nga verifikimi i dokumentacionit në Drejtorenë e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative rezulton se kontratatat në IAL për personelin akademik, ndihmës akademik dhe atë administrativ, janë hartuar nga struktura e përkatëse e këtij institucioni konform përcaktimeve të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

Përshkrimi i punës është parashikuar në rregulloren nr.10921/9 prot., datë 08.09.2020 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndihmës Akademike-Administrative”, ku nga auditimi u konstatua se ato nuk ndodhen në dosjen personale të punonjësve, por në një dosje të veçantë.

Gjithashtu u konstatua se për periudhën objekt auditimi, nuk rezulton të jenë kryer vlerësimi vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, në përputhje me përcaktimet e rregullores se brendshme nr.10921/9 Prot., datë 08.09.2020 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndihmës Akademike-Administrative”, miratuar me

vendim të Senatit Akademik nr.26, datë 08.09.2020, ku në pikën 19 të saj parashikohet se: “*propozon dhe zhvillon politikat dhe procedurat lidhur me zhvillimin e karrierës për personelin e UGJ, ngritjen e kapaciteteve, menaxhimin e vlerësimit të performancës, si dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre.*”

Titulli i gjetjes: Për periudhën objekt auditimi, nuk ishin kryer vlerësimet vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, referuar përcaktimeve në pikën 19, të rregullores së brendshme nr.10921/9 Prot., datë 08.09.2020 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndihmës Akademike-Administrative”, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.26, datë 08.09.2020.

Nr. i Gjetjes 2	
Subjekti i audituar	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër (UGJ).
Njësität/ subjektit e interesuara nga gjetja	UGJ; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përbledhja e bazës ligjore	Rregullore e brendshme nr.10921/9 Prot., datë 08.09.2020 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndihmës Akademike-Administrative”, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 26., datë 08.09.2020.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Për periudhën objekt auditimi, nuk ishin kryer vlerësimet vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, referuar përcaktimeve në pikën 19, të rregullores së brendshme nr.10921/9 prot., datë 08.09.2020.</p> <p>Kriteri: Kjo situatë nuk është sipas kërkësave të pikës 19, të rregullores së brendshme nr.10921/9 Prot., datë 08.09.2020 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndihmës Akademike-Administrative”, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.26., datë 08.09.2020.</p> <p>Efekti: Pa ndikim financiar, por me ndikim në përbushjen e objektivave të njësisë.</p> <p>Shkaku: Mos përbushje e procedurave të përcaktuara në rregullore, që lidhen me vlerësimet vjetore të punës.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Bazuar në opinionin e mësipërm, nivelin e riskut për këtë rast e vlerësojmë: Të mesëm.
Konkluzioni	UGJ nuk kryer procedurat për vlerësimet vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, referuar përcaktimeve në pikën 19, të rregullores së brendshme nr.10921/9 Prot., datë 08.09.2020.
Rekomandimi	Të bëhen rregullisht vlerësimet vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, referuar përcaktimeve në pikën 19, të rregullores së brendshme nr.10921/9 Prot., datë 08.09.2020.
Afati i fundit përzbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, audit shprehet se për periudhën objekt auditimi sistemet e kontrollit në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.

Nga shqyrtimi i mëtejshëm i dokumentacionit rezulton se Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër, nuk ka procedura lidhur me vlerësimin dhe analizimin e nevojave për trajnim të personelit si dhe nuk disponon një plan trajnimi dhe kualifikimi që të synojë t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur, i cili hartohet mbi bazën e identifikimit të nevojave të punonjësve, përcaktuar në nenin 4, pika 20 të rregullores nr. 10921/9 Prot., datë 08.09.2020 “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve ndihmës Akademike-Administrative”.

Zbatimi i kritereve të përcaktuara për punësimet e reja (Rekrutimi)

Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikon në pikën 1, të nenit 57, që personeli i institucioneve të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës-akademik dhe personeli administrative.

Sipas procedurës standarde të përcaktuuar në Statutin e UGJ, bazuar në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", për peridhën 2019-2021, për periudhën 2019-2021, janë realizuar disa procedura punësimi, konkretisht:

- Rekrutime me kohë të plotë 17 gjithsej.
- Rekrutime të personelit me kohë të pjesshme 66 punonjës fgjithsej.
- Rekrutime të perosnelit të ftuar 35 gjithsej.

Punësimi i punonjësve të UGJ, është bërë me procedura konkurrimi. Kriteret e punësimit janë përcaktuar në statutin e institucionit dhe rregulloren e brendshme të tij.

Në rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit, janë përcaktuar përgjegjësítë për çdo zyrë dhe punonjës, ku janë vendosur procedura transparente për rekrutimin dhe emërimin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe janë vendosur kriteret dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin akademik dhe administrativ të institucionit dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent.

Administratori i Universitetit, që është dhe nepunësi autorizues ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësilë e strukturave përkatëse të njësisë, në rregulloren e brendshme të institucionit. Konstatohet se rekrutimi është kryer në zbatim të plotësimit të pozicioneve të parashikuar në strukturën e miratuar me vendim të BA. Gjithashtu, evidentohet se ka përputhje të kritereve profesionale me kërkesat e vendit të punës për punonjësit aktual dhe për punësimet e reja. Institucioni ka ndjekur në vijimësi hapat e punësimit sipas parashikimit, përkatësisht në nenet 27, 29 dhe 38 të statutit dhe neneve 55, 56 dhe 57 të rregullore së brendshme të institucionit.

Punësimi i personelit të ftuar është bërë në përputhje me përcaktimet e parashikuara në rregulloren e brendshme të institucionit. Nga praktikat e verifikuara me kampionim rezulton se njësia e burimeve njerëzore ka andministruar rast pas rasti në fillim të vitit akademik kërkseat e njësive bazë sipas parashikimeve të neneve 62 të Ligjit nr.80/2015, si dhe të nenit 50, të statutit propozimin për perosnel akademik të ftuar. Pas kësaj procedure Senati akademik ka kryer miratimin e listës së personelit akademik të ftuar dhe vendimin ja ka dërguar bordit të administrimit.

Në tabelën e më poshtëme jepen të dhënat për numrin e personelit të ftuar sipas viteve:

Nr	Vitet akademike	Numri i personelit të ftuar
1	2018-2019	11
2	2019-2020	12
3	2020-2021	11
4	2021-2022	24

Nga tabela përmbledhëse vërejmë se nr.i personave ka adhur në rritje me 13 nga viti paraardhës; ka rritje të numrit të intelektualëve të fushave të ndryshme me 13 në cilësinë e “Të Ftuarve”.

Administrimi i dosjeve të personelit.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në çdo institucion përgjigjet për mbajtjen dhe sistemimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar. Sipas organikës së vënë në dispozicion nga institucioni, rezulton se kjo detyre kryhet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative. U kërkua të verifikohej mbajtja dhc sistemimi i dosjeve të personelit. U përzgjodhi në mënyrë rastësore disa prej dosjeve të administruara nga kjo njësi.

Nga dosjet e verifikuara rezulton se nuk janë përbushur detyrat funksionale që lidhen me mbajtjen dhe sistemimin e dosjeve, parashikuar në mënyrë eksplikite në vendimin nr.833, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e hollësishme për përbajtjen, procedurën e administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrat qendror të personelit". Kështu, në asnjë prej dosjeve të shqyrtuara nuk ka fletë inventari, sipas lidhjes nr.2, të VKM-së nr. 833, datë 28.10.2020, e cila duhet të përbajë listën me të gjithë dokumentacionin që ndodhet në dosje, si dhe nuk ka fletë prezantuese të dosjes teknike, ose fletë prezantuese të modeleve të kaluara. Nga dosja në dosje dokumentacioni i administruar nuk është i njëjtë, duke evidentuar mangësi. Konstatohet se dokumentacioni i dosjeve është fotokopje dhe jo kopje e noterizuar në pjesën më të madhe të tyre. Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrativ na bëri me dije se po rishikon çdo dosje të personelit të rekrutuar para vitit 2021, për t'i plotësuar me dokumentacionin përkatës (në rast mungese) sipas standardeve dhe në përputhje me aktin nënligjor të sipërcituar.

Titulli i gjetjes: Në dosjet e personelit u konstatuan mangësi, pasi nuk ka fletë inventari, nuk ka fletë prezantuese të dosjes teknike, si dhe dokumentacioni i dosjeve është fotokopje dhe jo kopje e noterizuar jo në përputhje me përcaktimet në kreun II, pika 1, lidhjet nr.1 dhe nr.2, të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përbajtjen, procedurën e administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrat qendror të personelit".

Nr. i Gjetjes 3	
Subjekti i Audituar	Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër (UGJ).
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	UGJ; Ministria e Arsimit dhc Sportit.
Përbledhje e bazës ligjore	VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrat qendror të personelit".
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Në dosjet e personelit u konstatuan mangësi, pasi nuk ka fletë inventari, nuk ka fletë prezantuese të dosjes teknike, si dhe dokumentacioni i dosjeve është fotokopje dhe jo kopje e noterizuar. Kriteri: Mos plotësimi i dosjeve me dokumentacion, është jo në përputhje me përcaktimet në kreun II, pika 1, lidhjet nr.1 dhe nr.2, të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përbajtjen, procedurën e administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrat qendror të personelit". Ndikimi/Efekti: Shkelje e procedurave ligjore pa ndikim financiar; Shkaku: Mungesa e procedurave dhe kontolleve që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm
Konkluzioni	Ndikimi ka qënë mos respektim i procedurave ligjore lidhur me plotësimin e dosjeve të punonjësve të UGJ me dokumentacion. Marrja e masave dhe vendosja e kontolleve, ndaj risqeve të

	identifikuara, eleminon mundësinë e ndodhjes dhe përsëritjes së ngjarjeve të pa dëshiruara.
Rekomandimi	Njësia e burimeve njerëzore në UGJ, të bëjë plotësimin, sistemimin dlie administrimin e dosjeve të personelit për çdo të punësuar, referuar përcaktimeve në VKM-në nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrat qendror të personelit”.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimit vlerësojmë se sistemet e kontrollit lidhur me plotësimin me dokumentacion të dosjeve të punonjësve të ZVA, nuk kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

3. Auditim mbi funksionimin e Bordit të Administritimit, numri i anëtarave dhe përbërja e bordit, organizimi dhe funksionimi i bordit, ushtrimi i funksioneve për përbushjen e detyrave dhe përputhshmëria e vendimeve të marrame aktet ligjore në fuqi.

Bordi i administritimit është organi më i lartë kolegjial administrativ vendimmarrës që mbikëqyr dhe kontrollon veprimtaritë e UGJ, i cili garanton përbushjen e misionit të IAL, mbarëvajtjen fianaciare dhe administrative të tij. Bordi i administritimit përbëhet nga 7 anëtarë të punësuar me kohë të pështme nga të cilët 3 (tre) anëtarë janë të emëruar nga ministria përgjegjëse për arsimin, ndërsa 3 (tre) janë anëtarë të personelit akademik të UGJ-së, për një mandat 5-vjeçar (pesëvjeçar), me të drejtë rizgjedhjeje dhe një anëtar si përfaqësues i ministrisë së arsimit përzgjidhet nga studentët e UGJ-së.

Për përbushjen e misionit BA, ka ushtruar funksionet e tij të përcaktuara në nenin 49, të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 21, të statutit, si më poshtë:

- Ka hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të Bordit të Administritimit.
- Ka miratuar planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe ka realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e tij.
- Ka miratuar buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe ka realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e tyre.
- Ka miratuar numrin e personelit në të gjitha nivelet.
- Ka dhënë mendim për projekt rregulloren e universitetit.
- Ka përcaktuar rregullat për shpërndarjen e të ardhurave dhe ka mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit.
- Ka përcaktuar kriteret e procedurave për punësimin e personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit.
- Ka miratuar paraprakisht statutin e universitetit dhe ja ka përcjellë Senatit Akademik;
- Ka miratuar raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se Bordi i Administritimit:

- nuk është miratuar rregulloren financiare të universitetit, referuar përcaktimeve të nenit 49 pika ‘e’, të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015, ku citohet: “*jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij*”, si dhe përcaktimeve në nenin 21, pika 4, të statutit, ku citohet: “*Miraton rregulloren për administrimin, financat dhe kontabilitetin*”.

- nuk mbahen me shkrim (me protokoll) diskutimet e anëtareve të BA apo të regjistruara me audio, por është mjaftuar me përpilimin e proces-verbalit në përfundim të mbledhjes. Mbajtja e protokollit të mbledhjeve të BA, duhet të përfshihet në rregulloren e brendshme të Bordit të Administrimit.

Titulli i gjetjes: Nuk ishte miratuar rregullorja për administrimin, financat dhe kontabilitetin, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet në nenin 49 pika ‘e’, të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 dhe nenin 21, pika 4, të statutit.

Nr. i Gjetjes 4	
Subjekti i audituar	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër (UGJ).
Njësité/ subjektet e interesuara nga gjetja	UGJ; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financier dhe kontrollin”, i ndryshuar;
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nuk ishte miratuar rregullorja për administrimin, financat dhe kontabilitetin, referuar përcaktimeve në nenin 49 pika ‘e’, të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 dhe nenin 21, pika 4, të statutit. Kriteri: Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 49 pika ‘e’, të Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 dhe nenin 21, pika 4, të statutit. Efekti: Mos zbatim i kërkesave ligjore lidhur me miratimin e rregullores finanziare. Shkaku: Mos përbushje e detyrimeve të përcaktuara në ligj dhe statut që lidhen me situatën.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Bazuar në opinionin e mësipërm, nivelin e riskut për këtë rast e vlerësojmë: Të mesëm.
Konkluzioni	BA, nuk ka përbushur detyrimet që lidhen me miratimin e rregullores për administrimin, financat dhe kontabilitetin .
Rekomandimi	Të merren menjëherë masa për hartimin dhe miratimin e rregullorës për administrimin, financat dhe kontabilitetin, referuar përcaktimeve në aktet ligjore në fuqi.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, audit shprehet se sistemet e kontrollit të brendshëm në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.

4. Auditim i sistemit të pagave dhe përputhshmëria me legjisacionin, dokumentimi i prezencës në punë të punonjësve (listëprezencia), hartimi i listëpagesave dhe llogaritja e pagave, shtesave lidhur me ngarkesën mësimore, pagesat për pedagogë me kohë të pjesshme, shpërbilimet, si dhe pagesat për honorarë të ndryshme etj, llogaritja e tatimit mbi të ardhurat personale, kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe xhirimi i tyre në favor të buxhetit të shtetit.

Nga auditimi me zgjedhje lidhur me sistemin e pagave, zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës e të pagave, llogaritjen e tyre, sistemi i listë-pagesave, sigurimet shoqërore e shëndetësore, rezultoi se prezenca në punc dhe koha e punës së punonjësve evidentohet rregullisht, me list-piezëncë, e cila nënshkruhet rregullisht.

Përllogaritja e pagesave në listë-pagesat e punonjësve, ishte bërë mbi bazën e listë-prezencave në pune të punonjësve, të hartuar dhe të miratuara nga çdo strukturë, si dhe sipas pozicionit, kategorisë se pagës, të përcaktuar në VKM nr.748 datë 11.06.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar. Në lidhje me ngarkesën mësimore të personelit akademik, pagesat ishin bërë referuar Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar. Për çdo punonjësështë e evidentuar vjetërsia në pune dhe bazuar në këto të dhëna janë përllogaritur pagesat për vjetërsi në pune 2% për çdo vit, por jo më shumë se 25 vjet. Liste pagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (liste-prezencia e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse), si dhe kontrolloheshin dhe nënshkruheshin nga punonjësi i caktuar, nëpunësi zbatues dhe Administratori i UGJ, referuar përcaktimeve në paragrafin 69, të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Listë pagesa, e cila shoqëron urdhrin për shpenzimin e pagave, nënshkruhet nga nëpunësi zbatues dhe nga nëpunësi Autorizues, referuar përcaktimeve në paragrafin 70, të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Për rastet e dhënies së lejeve vjetore administroheshin në çdo rast urdhrat dhe autorizimet e titullarit.

Kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore që paguhen nga punëdhënësi dhe atyre që paguhen nga punëmarrësi janë përllogaritur ndaluar dhe kaluar në favor të buxhetit të shtetit, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.7703 dt.11.03.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar, VKM nr.1114 dt.30.07.2008 “Për zbatimin e Ligjit nr.7703 dt.11.03.1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar, por gjatë auditimit u konstatuan parregullësi të karakterit të përputhshmërisë ligjore lidhur me deklarimin e punonjësve apo deklaratave tatimore në sistemin tatimor konkretisht:

Me urdhër shpenzimin nr.365, datë 20.09.2019, ishte xhiruar Drejtorisë së Tatim Taksave, shuma 159 265 lekë “*Gjobë nga deklarimi i vonuar në sistemin tatimor*” dhe me urdhër shpenzimin nr.275 dhe nr.276 datë 05.10.2020, ishte xhiruar Drejtorisë së Tatim Taksave shuma 25 000 lekë “*Gjobë nga deklarimi i vonuar në sistemin tatimor*”, veprime këto jo në përputhje:

- me pikën 1, të nenit 64, të Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku citohet “*Tatimpaguesi dorëzon deklaratë të plotë dhe të saktë tatimore brenda afateve të përcaktuara në legjisacionin tatimor përkatës*”;
- me pikën 3, të nenit 11, të Ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet; “*Personi juridik e fizikës eshtë i detyruar të deklarojë zyrtarisht, në organin tatimor, çdo punonjës që fillon punë për herë të parë te subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendare përparrë fillimit të punës*”. Për deklarimet e vonuara të punonjësve, UGJ eshtë penalizuar me gjobë në shumën 184 265 lekë nga organet tatimore. Nga UGJ nuk eshtë analizuar dhe nxjerrë përgjegjesia për këto raste, por janë likuiduar, duke krijuar kosto me efekt negativ për UGJ.

Titulli i gjetjes: Gjatë viteve 2019-2020, ishin bërë deklarime me vonesë në sistemin tatimor për punonjësit apo deklaratave tatimore, veprime jo në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 64, të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, si dhe me pikën 3, të nenit 11, të Ligjit nr.9136, datë 11.9.2003.

Nr. i Gjetjes 5	
Subjekti i Audituar	Universiteti i Gjirokastrës.
Njësitét/subjektet interesuara për gjetjet	Administratori i UGJ. Rektori i UGJ.
Përbledhje e bazës ligjore	Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Gjatë viteve 2019-2020, ishin bërë deklarime me vonesë në sistemin tatimor, për punonjësit apo deklaratave tatimore.</p> <p>Kriteri: Deklarimi me vonesë në administratën tatimore i punonjësve apo deklaratave tatimore, është jo në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 64, të Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku citohet: “<i>Tatimpaguesi dorëzon deklaratë të plotë dhe të saktë tatimore brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin tatimor përkatës</i>”; në pikën 3, të nenit 11, të Ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet: “<i>Personi juridik e fizik është i detyruar të deklarojë zyrtarisht, në organin tatimor, çdo punonjës që fillon punë për herë të parë te subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendarike përparrë fillimit të punës</i>”.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Shkelje e procedurave ligjore me ndikim finansiar negativ në shumën 184 265 lekë për UGJ;</p> <p>Shkaku: Mungesa e procedurave dhe kontolleve që lidhen me situatën.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm
Konkluzioni	Mos respektimi i procedurave ligjore lidhur me deklarimin e punonjësve të UGJ, në sistemin tatimor, duke krijuar efekt finansiar negativ në shumën 184 265 lekë. Marrja e masave dhe vendosja e kontolleve, ndaj risqeve të identifikuara, clemion mundësinë e ndodhjes dhe përsëritjes së ngjarjeve të pa dëshiruara.
Rekomandimi	UGJ, për deklarimet e punonjësve në sistemin tatimor të marrë masa për respektimin e afateve ligjore dhe vendosjen e kontolleve të nevojshme, referuar përcaktimeve ligjore në fuqi.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Referuar konstatimit sa më sipër, sistemet e kontrollit në këto raste nuk kanë vepruar në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Tatimi mbi pagat e punonjësve është përllogaritur, ndaluar nga paga e punonjësve dhe kaluar në favor të buxhetit të shtetit, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, por u konstatua parregullësi e karakterit të përputhshmërisë ligjore në rastin e pagesave të honorarëve për projektet e realizuara, për pagesat e orëve shtesë mbi pagë të punonjësve të personelit akademik, si dhe të pedagogëve të ftuar, shumat e përfituar nuk ishin tatuari sipas kërkesave të këtij ligji, si dhe të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.3 “Të ardhurat e tatueshme”, nënpika 2.3.1 germa ‘b’ ku citohet: “*Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitetet, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikqyrëse etj., paguhet në qendrën efektive të punës së individit, këto të ardhura do të tatoohen duke u bashkuar me pagën e muajit përkatës*”.

Titulli i gjetjes: Aplikimi i tatimit mbi pagesat e honorarëve për projektet e realizuara, pagesat e orëve shtesë mbi pagë të punonjësve të personelit akademik, si dhe pagesat e pedagogëve të ftuar, nuk është bërë sipas përcaktimeve në aktet përkatëse ligjore në fuqi.

Nr. i Gjetjes 6	
Subjekti i Audituar	Universiteti i Gjirokastrës.
Njësitë/subjektet e interesuara për gjetjet	Administratori i UGJ. Rektori i UGJ.
Përbledhje bazës ligjore	Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Udhëzimi nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	<p>Situata: Në rastin e pagesave të honorarëve për projektet e realizuara, për pagesat e orëve shtesë mbi pagë të punonjësve të personelit akademik, si dhe të pedagogëve të ftuar, shumat e përfituar nuk janë tatuari sipas kërkesave të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.3 “Të ardhurat e tatueshme”, nënpika 2.3.1 germa ‘b’, ku citohet: “<i>Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitetet, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikqyrëse etj., paguhet në qendrën efektive të punës së individit, këto të ardhura do të tatoohen duke u bashkuar me pagën e muajit përkatës</i>”.</p> <p>Kriteri: Tatimi mbi pagesat e honorarëve për projektet e realizuara, pagesat e orëve shtesë mbi pagë të punonjësve të personelit akademik, si dhe pagesat e pedagogëve të ftuar, nuk është mbajtur në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.3 “Të ardhurat e tatueshme”, nënpika 2.3.1 germa ‘b’.</p> <p>Ndikimi/Efekti: Ka ndikim financiar. Përllogaritjet e këtij ndikimi për çdo rast e punonjës të bëhet nga UGJ, për periudhën objekt auditimi.</p> <p>Shkaku: Mos njohja e aktit ligjor në këtë fushë.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm

Konkluzioni	Kjo situatë ka ardhur për shkak të mos zbatimit si duhet i akteve ligjore që lidhen me tatimin e të ardhurave personale. Marrja e masave dhe vendosja e kontrolleve ndaj risqeve të identikuara, eliminon mundësinë e ndodhjes së gabimeve e ngjarjeve të padëshiruara për Njësinë Publike.
Rekomandimi	UGJ të analizojë rastin, të nxjerri përgjegjësinë, të bëjë përllogaritjet për tatimin mbi të ardhurat, për periudhën e audituar, për çdo rast e punonjës, si dhe për diferencat e konstatuara të pa mbajtura të nxirren urdhër ç'dëmtimet, të kontabilizohen veprimet dhe të bëhen ndalesat përkatëse dhe të xhirohen në buxhetin e shtetit.
Afati për zbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Sa më sipër, audit shprehet se për periudhën objekt auditimi sistemet e kontrollit në këtë fushë nuk kanë vepruar në mënyrë efektive dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

5. Auditim i sistemit të buxhetit dhe i burimeve të financimit: të ardhurat e krijuara nga burimet e vetë universitetit apo burime të tjera, të ardhura nga granti i buxhetit të shtetit, hartimi dhe zbatimi i buxhetit, përdorimi i fondeve, sipas destinacionit të përcaktuar në buxhetin e miratuar, rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit për shpenzimet e kryera, përdorimi i fondeve nga granti buxhetit dhe fondeve nga të ardhurat e universitetit, përputhshmëria me legjislacionin.

Nga auditimi i ushtruar për periudhën objekt auditimi rezultoi se UGJ, është subjekt që funksionon sipas parimit të autonomisë financiare dhe ka si burime financimi fondet nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e krijuara nga burimet e vetë universitetit apo burime të tjera. Fondet nga buxheti i shtetit jepen në formën e grantit dhe sipas kategorive në përcaktuara në nenin 102 të statutit, të cilat përcaktohen sipas modelit të skemës së financimit të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Arsimit. Për përfitimin e këtyre fondeve, UGJ ka detyrimin e aplikimit. Fondet nga buxheti i shtetit i akordohen nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Të ardhurat nga burimet e vetë universitetit apo burime të tjera, referuar nenit 99, të statutit përfshijnë sa më poshtë:

- Pagesat e studentëve për arsim;
- Të ardhurat e krijuara nga të mësuarit përgjatë gjithë jetës;
- të ardhurat nga shërbimet e kryera për subjekte publike e private, vendase dhe të huaja, si edhe ndaj studentëve;
- të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palë të treta;
- donacione, dhurata, trashëgimitë;
- të ardhurat e krijuara nga veprimtaria kërkimore-shkencore;
- të ardhurat e krijuara nga dhënia me qira e mjediseve të cilat janë në administrim të UGJ-së, për palët e treta, në formën e kontratave të qiradhënieve apo me forma të tjera kontraktimi;
- burime të tjera të ligjshme financimi.

Të ardhurat e krijuara për periudhën objekt auditimi sipas viteve paraqiten në tabelën si më poshtë:

Vitet	Fonde te mbartura nga viti i meparshem	Fonde të akorduara nga Buxheti	Te ardhura të realizuara nga UGJ	Totali i fondeve gjithsej	Fonde të përdorura gjate vitit	Fonde pa papërdorur, gjendje me 31 Dhjetor.
2018	90,635,218	274,992,000	40,870,305	406,497,523	289,874,270	116,623,253
2019	116,623,253	204,526,519	32,703,468	353,853,240	277,909,122	75,944,118
2020	75,198,469	207,040,278	33,298,983	315,537,730	283,602,658	31,935,072
2021	31,935,072	187,257,221	47,299,967	266,492,260	262,949,242	3,543,018
2022 (Periudha Janar-31 Maj 2022)	3,543,017	182,351,255	14,361,246	200,255,518	99,181,399	101,074,119

Referuar të dhënavët në tēbelë rezulton se çdo vit ka fonde të papërdorura, të cilat janë mbartur në vitin pasardhës, referuar përcaktimeve të nenit 98, të statutit “Autonomia finanziare”, pika 1, shkronja ‘h’, ku citohet: “*Të gjitha të ardhurat e krijuara përdoren nga UGJ-ja dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës*”.

Referuar nenit 99, të statutit, “Burimet e financimit”, pika 2, të ardhurat e krijuara sipas pikës 1 të këtij neni, përvèç të ardhurave nga buxheti i shtetit, derdhen në llogarinë e UGJ-së dhe përdoren sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e miratuar nga BA-ja “*Mbi krijimin dhe përdorimin e fondeve të krijuara nga të ardhurat e UGJ-së*”, ndërsa referuar pikës 3, të ardhurat e përfituar nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, oponencat, hartimi dhe pjesëmarrja në projekte të kërkim-zhvillimit, nga transferimi i teknologjive, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimitaria ku merr pjesë personeli akademik i UGJ-së, ndahen ndërmjet personelit akademik dhe UGJ-së, në përputhje me rregulloren e brendshme për administrimin, financat dhe kontabilitetin në UGJ.

Hartimi i buxhetit të UGJ-së dhe struktura e tij, është bërë sipas modelit të buxhetit të shtetit, i përcaktuar në udhëzimin përkatës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për vitet objekt auditmi projekt-buxheti vjetor është hartuar nga administratori, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të UGJ-së dhe në planin buxhetor afatmesëm.

Administratori projekt buxhetin sipas viteve përkatëse e ka kaluar për diskutim në Rektorat dhe Senatit Akademik, të shoqëruar me relacion, si dhe pas sugjerimeve të tyre, projektbuxheti i është dërguar për miratim Bordit të Administrimit, i cili ka bërë miratimin e tyre sipas viteve përkatëse. Ndjekja e zbatimit të buxhetit bëhet nga Administratori i Institucionit, i cili është në pozitat e “Titullarit të njësisë publike”, sipas kuptimit që i jep nen 4, pika 22 dhe nen 8, i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financier dhe kontrollin” i ndryshuar.

Administratori i UGJ, buxhetin e miratuar, për çdo vit e ka dërguar tek Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, së bashku me vendimin përkatës të Bordit të Administrimit. Mbështetur në treguesit e programuar, zyra e financës ka ndjekur shpenzimet sipas artikujve duke mos tejkaluar kufijtë e shpenzimeve. Pasqyrimi i shpenzimeve është bërë në mënyrë të detajuar sipas veprimtarisë përkatëse dhe klasifikimit buxhetor.

Nga ana e UGJ, është rakorduar me Degën e Thesarit, për situacionet e shpenzimeve dhe të ardhurave, të cilat janë konfirmuar nga kjo degë për çdo muaj e në fund të viteve objekt auditimi. Për çdo pagese të kryer është dhënë autorizimi i Degës së Thesarit, duke u vulosur nga kjo degë, urdhër shpenzimi. Në asnjë zë të shpenzimeve nuk u konstatuan raste të përdorimit të fondeve mbi limitet e përcaktuar në planifikimet mujore të shpenzimeve sipas artikujve dhe kapitujve, të miratuar në buxhetin e periudhës së audituar. Kryerja e shpenzimeve është bërë rregullisht në mënyrë analitike dhe periodikisht çdo muaj, nëpërmjet degës së thesarit.

Lidhur me hartimin e PBA-ve të viteve objekt auditimi rezultoi të jenë dokumentuar propozimet e projekt buxhetit të ndërsjellta nëpërmjet strukturave (njësia kryesore dhe atyre bazë) të institucionit, deri në miratimin final të PBA-së, me qëllim hartimin e gjurmës së auditimit të këtij procesi. Gjithashtu UGJ, ka dërguar PBA e hartuara në MAS, sipas afateve respektive, por u konstatua parregullsi si vijon:

Rezultoi se për periudhën objekt auditimi nuk janë ngritur grupet e punës për hartimin e PBA-ve dhe menaxhimin e programeve, sipas viteve përkatëse, për rrjedhojë nuk janë përcaktuar përgjegjësitë e drejtuesit, si dhe të anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit, referuar përcaktimeve në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, pika 2.5 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit” dhe pika 2.6 “Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit”.

Gjithashtu projekt buxhetet e hartuara për periudhën objekt auditimi, nuk janë të argumentuara me dokumenta për sa i përket mënyrës së llogaritjes së fondeve sipas programeve, pasi mungojnë analizat përkatëse sipas zërave, si dhe nuk kanë raporte të hartuara për kërkeshat buxhetore sipas programeve apo një relacion të plotë për gjithëprogramin e UGJ, referuar përcaktimeve të pikës 8 të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.

Titulli i gjetjes: Mos ngritura e grupeve të punës për hartimin e PBA-ve dhe menaxhimin e programeve, mos dokumentimi e argumentimi i tyre për sa i përket mënyrës së llogaritjes së fondeve për çdo program dhe çdo njësi, veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.

Nr. i Gjetjes 7	
Subjekti i audituar	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër (UGJ).
Njësitë/ subjektit e interesuara nga gjetja	UGJ; Ministria e Arsimit dhe Sportit.
Përbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financier dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”.
Përvjetori i gjetjes	Situata: Për periudhën objekt auditimi nuk janë ngritur grupet e punës për hartimin e PBA-ve dhe menaxhimin e programeve, sipas viteve përkatëse, për rrjedhojë nuk janë përcaktuar përgjegjësit e drejtuesit, si dhe të anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit, referuar përcaktimeve në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, pika 2.5 “Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të

	<p><i>Programit</i>" dhe pikë 2.6 "Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit".</p> <p>Projekt buxhetet e hartuara për periudhën objekt auditimi, nuk janë të argumentuara për sa i përket mënyrës së llogaritjes së fondeve sipas programeve dhe njësive, pasi mungojnë analizat përkatëse sipas zërave, si dhe nuk kanë raporte të hartuara për kërkesat buxhetore sipas programeve, referuar përcaktimeve të pikës 8 të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA".</p> <p>Kriteri: Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA".</p> <p>Efekti: Mos zbatim i procedurave ligjore lidhur me hartimin projekt buxhetit.</p> <p>Shkaku: Mos njohja e plotë e kuadrit rregullativ nga personeli përgjegjës për hartimin e PBA.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Bazuar në opinionin e mësipërm, nivelin e riskut për këtë rast e vlerësojmë: Të lartë.
Konkluzioni	PBA-ja e hartuar për periudhën e viteve objekt auditimi paraqitet me mangësi lidhur me plotësinë dhe saktësinë e treguesve sasior e vlerorë, si dhe dokumentimin e tyre, veprime jo në përputhje të plotë me kërkesat e udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA". Më hollësisht, në zbatim të pikës 2.5 dhe pikës 2.6 të udhëzimit nr.7, për përgatitjen e PBA, rezulton të mos jenë përcaktuar Ekipet e Menaxhimit të Programeve, edhe pse institucioni për këtë periudhë ka menaxhuar fonde në programe të ndryshme.
Rekomandimi	Strukturat përgjegjëse për hartimin e projektbuxhetit, në vijim urdhërit të titullarit të institucionit "Për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programit", me qëllim menaxhimin efektiv të programeve buxhetore, të marrin masat për hartimin e dokumentit të projektbuxhetit për periudhat e ardhshme në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor, me qëllim përcjelljen për në MAS të një informacioni sa më të plotë dhe të saktë, duke përfshirë deklaratën e politikës së programit, produktet e programit dhe aktivitetet e programit.
Afati i fundit përzbatimin e rekomandimit	
Statusi i rekomandimit	

Lidhur me gjetjen sa më sipër, auditit shprehet se sistemet e kontrollit të brendshëm në këtë fushë kanë vepruar jo në përputhje të plotë me aktet ligjore në fuqi.

6. Auditim i sistemit të prokurimeve të fondeve publike, zbatimi i procedurave ligjore në prokurimin e fondeve publike lidhur me vlerësimin, planifikimin e nevojave konkrete për

investime, mallra dhe shërbime, argumentimi e përllogaritja e fondit limit, të projekteve, mallrave dhe shërbimeve, vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në momentin e lidhjes së kontratës, zbatimi i kontratave, marrja në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, si dhe inventarizimi dhe arkivimin e dosjes së procedurës së prokurimit.

Për periudhën objekt auditimi, UGJ, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka hartuar, miratuar dhe dërguar në APP, regjistrin e parashikimeve për prokurimin publik, si dhe regjistrin e realizimit të prokurimeve publike. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar dhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, zhvillimi i procedurave është bërë në zbatim të kërkesave të tyre.

Referuar regjistrave të realizimit të prokurimeve publike të UGJ, rezultoi se për periudhën objekt auditimi rezultoi se ishin zhvilluar procedura nën kufirin e ulët monetar, por mbi 800 000 (tetëqind mijë) lekë, si dhe procedura brenda kufirit monetar për prokurimet me vlerë të vogël.

Për mallrat dlie shëlbimet me vlerë nën 100 000 lekë, UGJ, kishte bërë planifikimin e tyre dhe vlerat përkatëse i kishte pasqyruar respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik. Pagesat për këto mallra e shërbime ishin bërë sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Për periudhën objekt auditimi u audituan me zgjedhje procedurat e prokurimit si më poshtë vijon:
Për vitin 2021:

- Procedura e prokurimit me objekt ”Blerje pajisje kompjuterike”, lloji i procedurës ”Kërkesë për propozim”, urdhri i prokurimit nr.05, datë 28.01.2021, data e shpërndarjes së njoftimit në sistemin elektronik 29.01.2021, numri i referencës REF-85084-01-28-2021, data e zhvillimit 11.02.2021, fondi limit 4 499 921 (katër million e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekë pa tvsh. Procedura është publikuar në butelinin nr.17, datë 8 Shkurt 2021, procedura është hapur më datë 11.02.2021, kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomik. Në procedurë nuk ka pasur të operator të skualifikuar. Rezulton i shpallur fitues operatori ”Atom” me nipt L22203042N, i renditur i pari me çmimin më të ulët me vlerë 3 080 000 (tre milion e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh. Njoftimi i fituesit është publikuar në butelinin nr.34, datë 8 Mars 2021, kontrata është lidhur me nr.283 prot, datë 09.03.2021, njoftimi i kontratës është publikuar në butelinin me nr.38, datë 16.03.2021, procedura është arkivuar me vendim nr. 03 ,datë 17.03.2021, malli është marrë në dorëzim nga komisioni më datë 09.03.2021 dhe është magazinuar me fletë hyrjen nr. 09, datë 12.03.2021.
- Procedura e prokurimit me objekt ”Blerje libra”, lloji i procedurës ”Kërkesë për propozim”, urdhri i prokurimit nr.24, datë 29.03.2021, data e shpërndarjes së njoftimit në sistemin elektronik 30.03.2021, numri i referencës REF-91454-03-29-2021, data e zhvillimit 09.04.2021, fondi limit 3 622 610 (tre milion e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë pa tvsh. Procedura është publikuar në butelinin nr.49, datë 6 Prill 2021, procedura është hapur më datë 09.04.2021, ku ka marrë pjesë vetëm operatori ”Argeta – LMG”, me nipt K31529061S, i cili është shpallur fitues me çmimin në vlerën 3 596 110 (tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e dhjetë) lekë pa tvsh. Njoftimi i fituesit është publikuar në butelinin nr.62, datë 26 Prill 2021, kontrata është lidhur me nr.495 prot, datë 28.04.2021, njoftimi i kontratës është publikuar në butelinin me nr.83, datë 31 Maj 2021, procedura është arkivuar me vendim nr.07, datë 25.05.2021, malli është marrë në dorëzim nga komisioni më datë 30.04.2021 dhe është magazinuar me fletë hyrjen nr.15, datë 30.04.2021.

- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje kancelari e bojra", lloji i procedurës "Kërkesë për propozim", urdhri i prokurimit nr.09, datë 02.02.2021, data e shpërndarjes së njoftimit në sistemin elektronik 03.02.2021, numri i referencës REF-85515-02-02-2021, data e zhvillimit 15.02.2021, fondi limit 2 000 000 (dy milion) lekë pa tvsh. Procedura është publikuar në buletini nr.17, datë 8 Shkurt 2021. Për kriteret është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik "Infosoft", me nr.154 prot, datë 09.02.2021. Procedura është pezulluar dhe ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës me urdhërin nr.11, datë 10.02.2021, i cili ka dhënë rekomadimet mbi ankesën me shkresën nr.155/1, datë 10.02.2021. Ankesa është miratuar me Vendim nr.02, datë 10.02.2021 dhe me shkresën nr 154/1 prot, datë 10.02.2021, i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik mbi ankesën e bërë prej tij. Procedura është hequr nga pezullimi me shkresën nr.11/1 datë 22.02.2021 dhe është zhvilluar më datë 01.03.2021, ku kanë marrë pjesë 6 operatorë ekonomik. Procedura është vlerësuar me datë 05.03.2021, ku rezulton të jenë skualifikuar 3 operator ekonomik (të renditur në vend të katërt, pesët dhe të gjashtë), me arsyetimin ligjor se nuk përbushin kriteret e përcaktuara në DST. Nga operatoret nuk ka pasur ankesa. Rezulton i shpallur fitues operatori ekonomik "InfoSoft Office", me NIPT J62426002Q, me çmimin më të ulët me vlerë 1,357,311 (një milion e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e njëmbëdhjetë mijë) lekë pa tvsh. Njoftimi i fituesit është publikuar në buletinin nr.42, datë 23 Mars 2021, kontrata është lidhur me nr.353 prot, datë 29.03.2021, njoftimi i kontratës është publikuar në buletinin me nr.58, datë 19 Prill 2021. Procedura është arkivuar me vendim nr.04 ,datë 12.04.2021, malli është marrë në dorëzim nga komisioni më datë 31.03.2021 dhe është magazinuar me fletë hyrjet nr. 10-14, datë 31.03.2021.

Për vitin 2020:

- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje karburanti", lloji i procedurës "Kërkesë për propozim", urdhri i prokurimit nr.43, datë 08.07.2020, data e shpërndarjes së njoftimit në sistemin elektronik 09.07.2020, numri i referencës REF-64655-07-08-2020, data e zhvillimit 20.07.2020, fondi limit 1 666 667 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh. Procedura është publikuar në buletini nr.42, datë 19 Korrik 2020 dhe rezulton të ketë paraqitur ankesë për dokumentat e tenderit operatori "Flady Petroleum". Procedura është pezulluar dhe ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës me urdhërin nr.52, datë 14.07.2020, i cili ka dhënë rekomadimet mbi ankesën me shkresën nr.778/1, datë 14.07.2020. Rezulton të jetë plotësuar shtojca për dokumentat e tenderit me nr. 837, datë 14.07.2021. Procedura është hequr nga pezullimi me shkressën nr.53 datë 14.07.2020 dhe është zhvilluar më datë 27.07.2020, ku ka marrë pjesë vetëm operatori ekonomik "Flady Petroleum", me NIPT L32622601G, me marzh fitimi të shprehur në përqindje 8.6% (tetë pikë gjashtë) lekë pa tvsh. Njoftimi i fituesit është publikuar në buletinin nr.55, datë 17 Gusht 2020, kontrata është lidhur me nr.1004 prot, datë 10.08.2020, njoftimi i kontratës është publikuar në buletinin me nr.55, datë 17 Gusht 2020, procedura është arkivuar me vendim nr.06, datë 13.08.2020, malli është marrë në dorëzim nga komisioni më datë 09.03.2021 dhe është magazinuar me fletë hyrjen nr.09, datë 12.03.2021.
- Procedura e prokurimit me objekt "Pajisje për laboratorin e infermierisë", lloji i procedurës "Kërkesë për propozim", urdhri i prokurimit nr.46, datë 15.09.2020, data e shpërndarjes së njoftimit në sistemin elektronik 18.09.2021, numri i referencës REF-72147-09-17-2020, data e zhvillimit 30.09.2020, fondi limit 7 153 226 (shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekë pa tvsh. Procedura është publikuar ne buletini nr.74 datë 21 Shtator 2020. Për kriteret është paraqitur ankesë nga operatoriet ekonomik, me urdhërin nr.74, datë 21.09.2020, ështëv pezulluar procedura për gabim ektronik. Rezulton të jetë plotësuar shtojca për modifikime në dokumentat e tenderit me nr.1146/1, datë 21.09.2020. Procedura

është hequr nga pezullimi me urdhërin nr.75, datë 21.09.2020. Për këtë procedur rezulton të ketë paraqitur ankes edhe operatori “Almedical”, me nr.1171, datë 24.09.2020, në vijim të së cilës është nxjerrë urdhër pezullimi nr.77, datë 25.09.2020. Komisioni i shqyrtimit të ankesave ka dhënë rekomadim mbi ankesën me shkresën nr.1187, datë 28.09.2020 dhe i është kthyer përgjigje operatorit për ankesën me shkresën nr.1171/1, datë 28.09.2020. Agjencia e Prokurimit Publik ka dhënë rekomandim me shkresën nr.1208, dattë 02.10.2020. Rezulton të jetë mbajtur proces verbal për disa shtesa dhe ndryshime me nr.1212, datë 02.10.2020, si dhe shtojca për modifikime në dokumentat e tenderit nr.1208/2, datë 02.10.2020. Me urdhërin nr.81, datë 14.10.2020, është bërë heqja e pezullimit dhe me datë 19.10.2020, është zhvilluar procedura, ku ka marrë pjesë vetëm operatori ekonomik “Fedos”, me NIPT K01514009I, i cili ka paraqitur çmimin me vlerë 7 150 000 (shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh. Njoftimi i fituesit është publikuar në buletinin nr.99, datë 9 Nëntor 2020, kontrata është lidhur me nr.1438 prot, datë 16.11.2020, njoftimi i kontratës është publikuar në buletinin me nr.38, datë 16.03.2021 dhe procedura është arkivuar me vendim nr.1550 ,datë 02.12.2020. Malli është marrë në dorëzim nga komisioni më datë 20.11.2020 dhe është magazinuar me fletë hyrjen nr.24, datë 20.12.2020.

- Procedura e prokurimit me objekt “Lyerja e fasadave dhe e ambienteve të brendëshme të Universitetit Eqrem Çabej”, lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”, urdhri i prokurimit nr.67, datë 17.08.2020, data e shpërndarjes së njoftimit në sistemin elektronik 18.08.2020, numri i referencës REF-68866-08-17-2020, data e zhvillimit 28.08.2020, fondi limit 4 381 376 (kater milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh. Procedura eshte publikuar në buletini nr.59, datë 24 Gusht 2020 dhe është hapur më datë 28.08.2020, ku janë paraqitur 22 operatorë ekonomik. Për operatorët “Ina” dhe “2N”, të renditur në dy vendet e para, ofertat e paraqitura kanë rezultuar me vlerë anomalisht të ulët, të cilëve u janë kërkuar shpjegime, operatorit ekonomik “Ina” me shkresën nr.1006, datë 11.09.2020 dhe operatorit ekonomik “2N” me shkresën nr.1005, datë 11.09.2020. Operatori ekonomik “Ina”, ka kthyer përgjigje për ofertën me shkresën nr.1189/2, datë 01.10.2020, ndërsa operatori ekonomik “2 N”, ka kthyer përgjigje për ofertën me shkresën nr.1005/1, datë 28.09.2020. Rezulton se janë skualifikuar 9 operatorë, nga të cilët ka paraqit ankesë operatori ekonomik “Ina”, me shkresën nr.1189, datë 29.09.2020. Për shqyrtimin e ankesës procedura është pezulluar me urdhërin nr.78, datë 30.09.2020. Për ankesën komisioni i shqyrtimit ka dhënë rekomandim me shkresën nr.1189/1, datë 29.09.2020 dhe i është kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankues “Ina” me shkresën nr.1189/2, datë 01.10.2020. Me urdhërin nr.83, datë 19.10.2020, është hequr pezullimi. Nga operatorët e kualifikuar është shpallur fitues operatori “CONGRENI”, me numri i NIPT-it J74818825K, me çmimin më të ulët me vlerë 2 720 054 (dy milion e shtatëqind e njëzet mijë e pesëdhjetë e katër) lekë pa tvsh. Njoftimi i fituesit është publikuar në buletinin nr.94, datë 2 Nëntor 2020, kontrata është lidhur me nr.1321 prot, datë 29.10.2020, njoftimi i kontratës është publikuar në buletinin me nr.9, datë 9 Nëntor 2020 dhe procedura është arkivuar me vendim nr.1551 ,datë 02.12.2020. Punimet kanë përfunduar me datë 24.12.2020, brenda afatit të parashikuar në kontratë. Gjithashtu rezulton të jetë bërë kolaudimi i punimeve, si dhe marrja në dorëzim. Në pagesat e kryera ishte mbajtur 5 % i granacisë së punimeve.

Për vitin 2019:

- Procedura e prokurimit me objekt “Blerje pajisje e instrumenta Laboratorike për Laboratorin e Arkeologjisë dhe Restaurimit”, lloji i procedurës “Procedure e hapur”, urdhri i prokurimit nr.82, datë 22.10.2019, data e shpërndarjes së njoftimit në sistemin elektronik me 31.10.2019, numri i referencës REF-41604-10-30-2019 , data e zhvillimit 26.11.2019, foni limit 10 044

072 (dhjetë milion dyzet e katër mijë e shtatëdhjetë e dy) lekë pa tvsh. Procedura është publikuar në buletini nr.44, datë 04 Nëntor 2019. Ka paraqitur ankesë operatori "Almedical", me nr.1476, datë 08.11.2019, të cilin i është kthyer përgjigje për ankesën me shkresën nr.1476/1, datë 08.11.2019 (ankesa jashtë afatit). Procedura është hapur më datë 26.11.2019, ku kanë marrë pjesë 2 operator ekonomik, ku rezulton se operatori ekonomik "Krijon" është skualifikuar, pasi nuk ka paraqitur ofertë dhe është shpallur fitues operatori ekonomik "Fedos", me NIPT K01514009I, me çmimin në vlerën 9 914 700 (nëntë milion e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë pa tvsh. Njoftimi i fituesit është publikuar në buletinin nr.50, datë 16 Dhjetor 2019, kontrata është lidhur me nr.1651 prot, datë 06.12.2019, njoftimi i kontratës është publikuar në buletinin me nr.51, datë 23.12.2019 dhe procedura është arkivuar me vendim nr.106 ,datë 13.12.2020. Malli është marrë në dorëzim nga komisioni dhe është magazinuar me fletë hyrjet nr. 43, datë 19.12.2019, nr. 44, datë 19.12.2019, nr. 10, datë 14.07.2020 dhe nr. 11, datë 14.07.2020.

- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje kompjutera", lloji i procedurës "Kërkësë për propozim", urdhri i prokurimit nr.49, datë 16.07.2019, data e shpérndarjes së njoftimit në sistemin elektronik 17.07.2019, numri i referencës REF-30485-07-16-2019, data e zhvillimit 29.07.2019, foni limit 1 690 000 (një million e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh. Procedura është publikuar në buletinin nr.29 datë 22 Korrik 2019 dhe është hapur më datë 29.07.2019, ku kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomik. Rezulton të janë skualifikuar 3 operator ekonomik, ku ka paraqitur ankesë operatori ekonomik "Blueprint technologies" me formularin e ankesës nr.1080, datë 13.08.2019. Procedura është pezulluar me urdhërin nr.60, datë 13.08.2019, për shqyrtimin e ankesës. Për ankesën komisioni i shqyrtimit ka dhënë rekomandim me shkresën nr.1090, datë 15.08.2019 dhe i është kthyer përgjigje ankesës me shkresën nr.1091, datë 16.08.2019. Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr.574, datë 30.08.2019, ka shpallur fitues operatorin "Sofia Myftari", me NIPT K42611766Q, me çmimin në vlerë 1 391 000 (një milion e treqind e nëntëdhjetë e një mijë) lekë pa tvsh. Njoftimi i fituesit është publikuar në buletinin nr.37, datë 16 Shtator 2019, kontrata është lidhur me nr.1158 prot, datë 11.09.2019, njoftimi i kontratës është publikuar në buletinin me nr.37, datë 16.09.2019 dhe procedura është arkivuar me vendim nr.1158/2 ,datë 16.09.2019. Malli është marrë në dorëzim nga komisioni më datë 17.09.2019 dhe është magazinuar me fletë hyrjen nr.30, datë 17.09.2019.

Për vitin 2018:

- Procedura e prokurimit me objekt "Shërbim Ruajtje Objekti me Roje Private", lloji i procedurës "Kërkësë për propozim", urdhri i prokurimit nr.142, datë 06.02.2018, data e shpérndarjes së njoftimit në sistemin elektronik 07.02.2018, numri i referencës REF-44404-02-06-2018, data e zhvillimit 19.02.2018, foni limit 5 127 674.08 (pesë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër pikë zero tetë) pa tvsh. Procedura është publikuar në buletinin nr.06, datë 12 Shkurt 2018 dhe është hapur më datë 19.02.2018, ku kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik. Kanë paraqitur ankesë operatorët "Anakonda" shpk, me formular ankesë nr.288, datë 02.03.2018 dhe "Grup 4", me formular ankesë nr.278, datë 02.03.2018. Procedura është pezulluar me urdhërin nr.298, datë 02.03.2018, për shqyrtimin e ankesës. Për ankesën komisioni i shqyrtimit ka dhënë rekomandim me shkresën nr.299, datë 02.03.2018 dhe i është kthyer përgjigje operatorit ankimues "Grup 4", me shkresën nr.317, datë 06.03.2018 dhe operatorit ankimues "Anakonda" shpk, me shkresën nr.309, datë 05.03.2018. Operatori "Anakonda", ka bërë ankesë drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, me formularin nr.324, datë 09.03.2018. UGJ me shkresën nr.326, datë 12.03.2018, i ka derguar KPP informacion për procedurën e prokurimit. KPP ka marrë vendimin nr.283/2018, datë

07.05.2018, të cilin ja ka dërguar UGJ me shkresën nr.283/I datë 07.05.2018. UGJ me urdhërin nr.06, datë 16.05.2018, ka hequr pezullimin. Komisioni i vlerësimit ka mbajtur proces verbalin nr.694, datë 16.05.2018, mbi renditjen përfundimtare në zbatim të vendimit të KPP. Rezulton se është shpallur fitues operatori ekonomik “Anakonda” shtip me NIPT K29009505I, i renditur i pari me çmimin më të ulët në vlerë 4 970 065.99 (katër milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e pesë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh. Njoftimi i fituesit është publikuar në buletinin nr.22, datë 4 Qershor 2018, kontrata është lidhur me nr.741 prot, datë 28.05.2018, njoftimi i kontratës është publikuar në buletinin me nr.22, datë 04.06.2018, procedura është arkivuar me vendim nr. 184 ,datë 04.06.2018 dhe shërbimi është kryer për 10 muaj e 5 ditë.

Nga auditimi i procedurave të mësipërme rezultuan mangësi, si më poshtë vijojnë:

- a.Nuk ishte dokumentuar përllogaritjen e vlerës së kontratave, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet, jo në përputhje me përcaktimet në kreu X “Zhvillimi i procedurave”, nen 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku citohet: “*Autoriteti/enti kontraktor, përparrat nxjerrjes së uredhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”.
